



BASHKIA KORÇË

Përmbajtja e Buxhetit 2017

1. Hyrje

2. Planifikimi i të ardhurave 2017

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Të ardhurat nga Institucionet e Varësisë

Transferta e pakushtëzuar 2017

Transferrat specifike 2017

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

3. Planifikimi i shpenzimeve 2017

Shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime shoqërore)

Shpenzimet për pagesat e principalit dhe interesit nga huamarrja

Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve publike

Shpenzimet për subvencione

Transferta tek organizatat dhe individë

Fondi rezervë dhe fondi i emergjencave civile

4. Shpenzimet kapitale sipas programeve

Programi i infrastrukturës rrugore

Programi i shërbimeve publike

Programi i administrimit të përgjithshëm (projekttime dhe investime)

Programi i investimeve në kulturë

Programi i investimeve në arsim

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

5. Planifikimi i shpenzimeve për Institucionet e Varësisë 2017

-Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes

- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

-Klubi Shumësportësh

-Klubi i Futbollit

-Qendra e Artit dhe Kulturës

-Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social

-Qendra Ditore e Zhvillimit

-Qendra Rezidenciale e Zhvillimit



BASHKIA KORÇË

-Shtëpia e Foshnjës

6. Planifikimi i shpenzimeve për Funksonet e Reja 2017

-Ujitja dhe Kullimi

-Rrugët Rurale

-Mbrojtja nga Zjarri

-Administrimi i Pyjeve

7. Planifikimi i buxhetit të Bashkisë 2018-2019

8. Baza ligjore

9. Tabelat përmbledhëse



BASHKIA KORÇË

1. Hyrje

Në buxhetin e Bashkisë, Njësive Administrative, Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të reja për vitin 2017 do të pasqyrohen të gjitha burimet e financimit dhe shpenzimet. Bashkia harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj, pa defiqit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

Viti 2017 shënon një moment historik në thellimin e decentralizimit dhe të autonomisë së pushtetit vendor, në zbatim të Reformës administrativo-territoriale. Rritja e kompetencave dhe fondeve për qeverisjen vendore në fusha dhe sektorë zhvillimorë si bujqësia, pyjet, rrugët, e transformon rrënjësisht konceptin e pushtetit vendor duke i dhënë një dimension të ri qeverisjes vendore, në një dhe më shumë mundësi zhvillimi, duke sjellë dukshëm edhe një përmirësim të shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe klimës së të bërit biznes.

Misioni

- Bashkia Korçë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve.
- Respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të saj.
- Zgjedhjen e llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore.
- Realizimi i shërbimeve në përputhje me standartet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Parimet e qeverisjes së mirë për mobilizimin e të ardhurave:

-parimi i përfitimit

Nëse paguaj, duhet të përfitoj shërbim. Por jo të gjitha shërbimet financohen në bazë të parimit.

-parimi i drejtësisë

Përdoruesit me aftësi të ngjashme duhet të paguajnë shumën të ngjashme.

-parimi i neutralitetit

Taksat/tarifat nuk duhet të favorizojnë ndonjë grup apo sektor në raport me një tjetër.

-parimi i përgjegjshmërisë

Të qartë për taksapaguesit se sa duhet të paguajnë dhe përse i përdor paratë qeveria.

-parimi i përshtatshmërisë dhe stabilitetit

Të ardhura të mjaftueshme për të financuar shërbimet bazë rregullisht dhe në vazhdimësi, të ardhura të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

-parimi i autonomisë

NJQV kanë nevojë për autonomi dhe fleksibilitet për të vendosur prioritetet e tyre. Ato duhet të minimizojnë varësinë e tyre nga të ardhurat e QQ.

-parimi i minimizimit të kostove administrative

Llogaritja dhe vlerësimi, mbledhja dhe administrimi i tarifave/taksave nuk duhet të konsumojë kohë as për qeverinë dhe as për taksapaguesin.

-parimi i thjeshtësisë

Vlerësimi tatimor duhet të jetë lehtësisht i kuptueshëm, përjashtimet të jenë të kufizuara dhe të kenë një arsye të qartë.

**Objektivat kryesorë për buxhetin vendor të vitit 2017**

- Rritja e autonomisë fiskale.
- Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore të NJVQV-ve për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve.
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë, thjeshtësisë dhe barazisë në sistemin e transfertave, së bashku me rritjen e transparencës.
- Përmirësimi i sistemit të administrimit të financave publike në nivel vendor.
- Përmirësimi i procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit.
- Financime të integruara sipas instrumentit të Politikës së Zhvillimit Rajonal, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në shpërndarje, si dhe bashkërendim me objektivat kombëtarë.
- Financimi i funksionimit dhe mirëmbajtjes së aseteve (eskavatorëve) për funksionin e ujitjes dhe kullimit do të ketë efekte të drejtpërdrejta në sigurimin e pronës dhe rritjen e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.
- Konsolidimi i funksioneve të reja të transferuara në njësitë e qeverisjes vendore.
- Në vitin buxhetor 2017, do të ketë një politikë të re për rritjen e pagave, e cila synon rritjen e performancës së burimeve njerëzore në nivel vendor.

2. Planifikimi i të ardhurave 2017**Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore**

Në planifikimin e të ardhurave është e rëndësishme: të njohësh ligjet kryesore, të aplikosh modele të ndryshme parashikimi, të shfrytëzosh të dhënat e viteve të mëparshme, të njohësh faktorët me ndikim të ndjeshëm, të zotërosh informacione dhe të dhëna aktuale dhe të shfrytëzosh eksperiencën personale dhe atë prezent.

Në tabelën e mëposhtme po pasqyrojmë ecurinë dhe realizimet e taksave dhe tarifave për vitet 2012 – 2016 (i pritshmi) si dhe planifikimin për vitin 2017:

Nëse i analizon realizimet e shumë prej zërave kanë ardhur me rritje nga viti në vit duke pasqyruar një përmirësim të dukshëm në administrimin dhe mbledhjen e të ardhurave, rritjen e kapaciteteve, rritjen e transparencës, fuqizimin e nivelit të bashkëpunimit si dhe monitorimin e performancës midis institucioneve. Vlen të theksohet se në realizimet që po paraqitim më poshtë kanë pasur ndikim dhe ndryshimet e herë pas hershme të kuadrit ligjor.

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	2012	2013	2014	2015	Real 11-m 2016	I prits 2016	2017
1	Tatim mbi ndërtesën	43,777,278	45,728,925	67,425,174	81,586,347	114,907,051	121,007,051	137,000,000
2	Tatim shitjeje pasuri e paluajtshme	3,828,227	6,461,126	5,663,311	9,231,294	3,074,747	3,443,120	9,000,000
3	Taksë mbi truallin	0	0	0	0	4,368,916	4,532,694	7,000,000
4	Taksë vendore B.V	89,192,648	82,769,863	41,487,797	56,065,508	11,159,989	11,248,989	40,000,000
5	Taksë rregjistrimi e përvitshme (automjete)	23,380,418	21,497,777	16,648,777	20,654,908	20,708,222	23,195,018	30,000,000
6	Taksë rregjistrimi e përvitshme (biznesi)	2,746,500	2,770,000	3,165,000	6,032,500	1,737,500	1,787,500	2,000,000
7	Taksë për ndërtimet e reja	4,929,863	118,347	1,695,305	8,512,697	61,193,038	64,573,335	180,000,000
8	Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet	4,563,744	2,735,019	449,262	4,253,803	6,813,352	7,371,661	20,000,000



BASHKIA KORÇË

9	Tarifë rregjistrimi për leje transporti	853,305	221,000	493,880	1,121,457	1,196,650	1,209,570	2,000,000
10	Taksë fjetje në hotel	1,886,089	1,786,448	1,666,638	3,327,481	2,623,837	3,003,840	3,900,000
11	Taksë therrjeje bagëti	761,150	744,600	754,600	784,900	498,350	548,350	700,000
12	Taksë reklame	13,103,438	13,744,478	18,551,722	12,854,785	3,555,850	3,555,850	9,000,000
13	Taksë tabele	261,280	247,250	250,970	356,529	12,118,862	12,572,456	19,000,000
14	Tarifë mur perimetral	87,410	0	23,000	149,326	376,378	400,438	700,000
15	Taksë tavoline	2,741,275	2,022,300	2,595,300	3,444,200	3,983,700	4,200,700	4,500,000
16	Tarifë pastrimi	49,719,607	58,843,384	62,825,304	73,698,794	101,677,846	107,577,847	117,000,000
17	Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata	5,991,427	5,925,621	10,526,585	9,791,464	10,527,021	10,877,020	16,000,000
18	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	0	0	0	0	58,800	58,800	50,000
19	Miratim projekti	0	0	0	0	255,500	305,500	500,000
20	Shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruara	0	0	0	0	0	0	90,000
21	Shërbime zjarrfikëse në bashki fqinje	0	0	0	0	0	0	300,000
22	Marrje me qera pylli	0	0	0	0	86,850	86,850	4,800,000
23	Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe heqja e materialit drusor	0	0	0	0	8761441	8,761,441	3,000,000
24	Vërtetime transporti	0	0	0	0	0	0	50,000
25	Prodhimet e dyta medicinale	0	0	0	0	0	0	100,000
26	Tarifë parkimi	2,422,740	1,943,306	5,480,070	13,466,927	15,364,784	16,864,784	21,000,000
27	Gjoha policia bashkiake	42,000	19,000	22,000	208,000	954,000	1,034,000	1,000,000
28	Gjoha të biznesit të vogël	619,873	757,239	447,455	2,204,066	5,616,931	6,027,181	5,500,000
29	Gjoha inspektoriati i ndërtimit	1,120,000	2,030,000	1,390,000	730,000	800,000	800,000	2,000,000
30	Gjoha të drejtorisë së kontrollit të territorit	125,000	55,000	33,000	149,000	581,100	581,100	1,000,000
31	Qira objekti, Qera Trualli, Qera T. bujqësore	1,550,338	819,935	1,305,032	2,198,063	3,933,856	4,233,856	14,620,471
32	Qira sipërmarrje	864,000	396,000	432,000	36,000	0	0	0
33	Tarifë për dhënien e treguesve të zhvillimit	0	0	192,000	90,000	267,000	277,000	700,000
34	Tarifë ndriçimi	15,424,960	17,774,749	23,704,862	27,549,002	33,778,744	35,778,744	39,955,000
35	Tarifë gjelbërimi	10,545,989	12,084,452	15,503,114	17,224,889	21,042,600	21,992,600	26,000,000
36	Tarifë servituti	377,060	337,820	679,464	657,368	1,217,221	1,225,141	2,000,000
37	Tarifë përdorimi i tregut të lirë të qytetit	5,316,780	501,160	4,262,690	2,646,420	519,530	519,530	0
38	Tarifë leje përdorimi kantina	1,081,351	824,450	915,100	787,970	14,750	14,750	0
39	Tarifë për ekspozim malli jashtë dyqanit	981,150	714,750	1,120,100	1,461,000	289,650	289,650	0
40	Taksë zënie hapësire publike	283,457	355,005	447,965	637,434	6,809,807	7,309,807	8,000,000
41	Tatim mbi tokën bujqësore	3,760,957	439,137	949,248	10,076,503	20,224,693	21,724,693	36,500,000
42	Të ardhura nga qiratë, banesa sociale	0	0	3,587,703	6,583,953	6,311,915	6,811,915	6,876,000
43	Taksë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	0	0	0	0	1,884,000	1,884,000	3,200,000
44	Qera nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave	0	0	4,678,958	3,743,702	3,038,472	3,258,472	5,272,800




BASHKIA KORÇË

45	Kamatë vonesa	0	0	0	0	188,610	191,906	0
46	Tarifë mirëmbajtje voreza publike	0	0	0	1,059,477	9,409,987	10,309,987	17,000,000
47	Tarifë uji	0	0	0	2,216,856	2,477,931	2,508,010	2,550,000
	TOTALI	292,339,314	284,668,141	299,373,386	385,592,623	504,409,481	533,955,156	799,864,271

Për të krijuar një ide në lidhje me trendin e realizimit të të ardhurave për vitet 2012 – 2016 (i pritshmi) si dhe planifikimin për vitin 2017 të dhënat e tabelës analitike të mësipërme po i paraqitim grafikisht si më poshtë:

	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhurat në vite	292,339,314	284,668,141	299,373,386	385,592,623	533,955,156	799,864,271



Gjithashtu më poshtë po pasqyrojmë në mënyrë analitike dhe grafike realizimin e të ardhurave për vitet 2012 – 2016 (i pritshmi) si dhe planifikimin për vitin 2017 të çdo taksë dhe tarifë:



BASHKIA KORÇË

TAKSA MBI NDËRTESEN

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tatim mbi ndërtesën	43,777,278	45,728,925	67,425,174	81,586,347	121,007,051	137,000,000

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2017 planifikohet të jetë në vlerën 137,000,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga subjektet e biznesit të vogël të Bashkisë Korçë në vlerën 31,361,150 lekë, nga subjektet e biznesit të madh të Bashkisë Korçë në vlerën 40,376,800 lekë, nga familjarët e njësisë administrative Korçë parashikohet në vlerën 25,490,300 lekë, nga familjarët e njësisë administrative të Bashkisë Korçë parashikohet në vlerën 4,889,750 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve të biznesit të Bashkisë Korçë parashikohet të arkëtohet në vlerën 34,882,000 lekë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017 :



TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	3,828,227	6,461,126	5,663,311	9,231,294	3,443,120	9,000,000



BASHKIA KORÇË

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për vitin 2017 parashikohet të jetë 9,000,000 lekë. Ky parashikim bazohet në realizimin e viteve paraardhëse por dhe në të dhënat e marra nga Z.V.R.P.P-Korçë e cila në rolin e agjentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017 :



TAKSA MBI TRUALLIN

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksë Trualli					4,532,694	7,000,000

Taksa mbi truallin për vitin 2017 planifikohet të jetë në vlerën 7,000,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga subjektet e biznesit të vogël të Bashkisë Korçë në vlerën 1,400,000 lekë, nga subjektet e biznesit të madh të Bashkisë Korçë në vlerën 3,800,000 lekë, nga familjarët e njësisë administrative Korçë parashikohet në vlerën 250,000 lekë, nga familjarët e njësive administrative të Bashkisë Korçë parashikohet në vlerën 400,000 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve biznesit të Bashkisë Korçë parashikohet në vlerën 1,150,000 lekë.




TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
T.TH.F.B.V	89,192,648	82,769,863	41,487,797	56,065,508	11,248,989	40,000,000

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël (taksa vendore për biznesin e vogël) për vitin 2017 parashikohet të jetë 40,000,000 lekë, pra po në të njëjtin nivel që ka qenë dhe në vitin 2016. Siç dhe e kemi theksuar dhe më parë është një ndër taksat që është prekur ndjeshëm dhe shpesh nga ndryshimet në legjislacionin tatimor, ku vlen të theksohen lehtësitë fiskale që iu janë bërë subjekteve të biznesit të vogël duke filluar që në vitin 2014, vit ku subjektet ndjenë për herë të parë lehtësimin e barrës së tyre fiskale dhe duke u pasuar me zerimin e kësaj takse për vitin 2016 për të gjithë subjektet me xhiro vjetore deri në 5 milion lekë dhe duke ulur tatimin e thjeshtuar mbi fitimin nga 7.5% në 5% për të gjithë subjektet me xhiro vjetore 5 deri 8 milion lekë. Ky zë planifikohet të realizohet në këtë vlerë nga subjektet debitore të cilët nuk e kanë paguar tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël deri në fund të vitit 2015, nga subjektet të cilët figurojnë debitorë për taksën vendore për biznesin e vogël nga vitet paraardhëse deri në 31.12. 2013 të cilët ju janë nënshtruar masave shtrenguese, nga subjektet të cilët kanë realizuar një qarkullim vjetor gjatë vitit 2016 më të madh se 5 milion lekë por që nuk e kanë arkëtuar akoma tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017






TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	23,380,418	21,497,777	16,648,777	20,654,908	23,195,018	30,000,000

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitin 2017 është planifikuar 30,000,000 lekë parashikim ky i bërë bazuar në realizimin e viteve paraardhëse por dhe në të dhënat e marra nga D.R.SH.T.R-Korçë e cila në rolin e agjentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017





BASHKIA KORÇË


TARIFË REGJISTRIM BIZNESI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë regjistrim biznesi	2,746,500	2,770,000	3,165,000	6,032,500	1,787,500	2,000,000

Tarifë regjistrim biznesi për vitin 2017 planifikohet në vlerën 2,000,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga subjektet e biznesit të vogël dhe të madh të Bashkisë Korçë të cilët figurojnë debitore deri në datë 31.12.2015 pasi prej vitit 2016 falë lehtësive fiskale që Bashkia Korçë ndërmori ndaj biznesit kjo tarifë u bë zero gjë e cila reflektoi impaktin e saj pozitiv në indicion e personave të cilët hapën biznes gjatë vitit 2016.

Vetëm për periudhën Janar - Nëntor 2016 numërohen 498 subjekte të regjistruara rishtaz apo subjekte të rretheve të tjera të cilat kanë hapur një adresë dytësore në Bashkinë Korçë duke nxjerë edhe njëherë në pah fokusin që Bashkia Korçë ka pasur duke e vlerësuar biznesin partner kryesor.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA


Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	4,929,863	118,347	1,695,305	8,512,697	64,573,335	180,000,000



BASHKIA KORÇË

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2017 planifikohet në vlerën 180,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Pavarësisht realizimit në nivele të ulta të kësaj takse për një periudhë 4 vjeçare pasi nuk ka patur miratime leje zhvëllimore ndërtimi për arsye të pezullimit të tyre, fakti që dhënia e lejeve të ndërtimit filloi prej muajit mars të vitit 2015 me kufizime (lejoreshin të ndërtoreshin vetëm banesa individuale me sipërfaqe ndërtimi deri në 250 m²) dhe në muajin shtator 2015 ku filluan të jepeshin leje ndërtimi sipas Planit të Përgjithshëm Vendor pasoi me një trend rritës të të ardhurave të arkëtuara nga kjo taksë për vitin 2016 krahasuar me vitet paraardhëse. Ky planifikim në këtë vlerë është bërë pasi pranë Bashkisë Korçë janë regjistruar elektronikisht një numër i madh kërkesish për leje ndërtimi.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET


Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	4,563,744	2,735,019	449,262	4,253,803	7,371,661	20,000,000

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2017 është planifikuar 20,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit duke u nisur nga të dhënat e vitit 2016 të cilat u shoqëruan me një trend në rritje të dhënieve të lejeve të legalizimit krahasuar me vitet paraardhëse gjë e cila parashikohet të vijojë dhe gjatë vitit 2017.



BASHKIA KORÇË

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë rregjistrimi për leje transporti	853,305	221,000	493,880	1,121,457	1,209,570	2,000,000

Tarifë rregjistrimi për leje transporti për vitin 2017 është planifikuar 2,000,000 lekë planifikim ky i bërë nga specialisti i transportit. Për këtë planifikim i është referuar ndryshimeve të fundit të legjislacionit aktual në fuqi në fushën e transportit, pasi një pjesë e mirë e licencave për subjektet që operojnë në këtë fushë sipas udhëzimeve të Ministrit të Transportit janë dhënë me afat 1 vjeçar me qëllim përshtatjen sipas kërkesave të ligjit.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017






TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa e fjetjes në hotel	1,886,089	1,786,448	1,666,638	3,327,481	3,003,840	3,900,000

Taksa e fjetjes në hotel për vitin 2017 planifikohet në vlerën 3,900,000 lekë, bazuar në realizimin e kësaj takse për vitin 2016, në subjektet të cilat nuk e kryen pagesën për këtë taksë brenda vitit 2016, në ndryshimet e legjislacionit tatimor, në ritjen e numrit të subjekteve që japin strehim kundrejt pagesës siç janë hotelet, motelet, bujtinat dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin administrativ të Bashkisë Korçë. Vlen të theksohet se vetëm për periudhën Janar – Nëntor 2016 numri i turistëve të akomoduar në hotelet, motelet, bujtinat dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim ka kapur shifrën e mbi 35 000 personave duke e vlerësuar si një nga vitet kulmore që flet bindshëm se Bashkia Korçë falë lehtësive fiskale për të gjithë operatorët që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe investimeve të kryera, po bëhet atraksion turistik gjatë gjithë vitit.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017





BASHKIA KORÇË

TAKSË THERJE BAGËTIE

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksë therrje bagëtie	761,150	744,600	754,600	784,900	548,350	700,000

Taksë therrje bagëtie për vitin 2017 është planifikuar 700,000 lekë, parashikim ky i cili bazohet në realizimin e kësaj takse në vitet e mëparshme por dhe formalizimit dhe shtrirjes së këtij shërbimi në të gjithë territorin e Bashkisë Korçë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




TAKSA E REKLAMËS

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa e Reklamës	13,103,438	13,744,478	18,551,722	12,854,785	3,555,850	9,000,000

Taksë reklame për vitin 2017 është planifikuar 9,000,000 lekë, parashikim ky i cili bazohet në administrimin e të dhënave për sipërfaqen reklamuese të ndodhur në Bashkinë Korçë për subjektet që nuk e paguan këtë taksë për vitin 2015 por dhe për vitet paraardhëse të cilat falë masave shtrërnguese të ndërmara dhe në proces jemi optimiste për rezultatet reale gjatë vitit 2017.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




TAKSA E TABELËS

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa e Tabelës	261,280	247,250	250,970	356,529	12,572,456	19,000,000

Taksë tabelle për vitin 2017 është planifikuar 19,000, 000 lekë, parashikim ky i cili bazohet në administrimin dhe pasurimin e të dhënave për numrin e tabelave identifikuese për orientim, sipërfaqen e tabelave identifikuese mbi 2m², sipërfaqen e tabelave reklamuese të ndodhur në Bashkinë Korçë, subjektet që nuk e paguan këtë taksë për vitin 2016 por dhe për vitet paraardhëse të cilat falë masave shtrërnguese të ndërmara dhe në proces jemi optimiste për rezultate reale gjatë vitit 2017.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017






BASHKIA KORÇË

TARIFË MUR PERIMETRAL

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë mur perimetral	87,410	0	23,000	149,326	400,438	700,000

Tarifë mur perimetral për vitin 2017 është planifikuar 700,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Pavarësisht realizimit në nivele të ulta të kësaj takse për një periudhë 4 vjeçare pasi nuk ka patur miratime leje zhvillimore ndërtimi për arsye të pezullimit të tyre, fakti që dhënia e lejeve të ndërtimit filloi prej muajit mars të vitit 2015 me kufizime (lejoheshin të ndërtoheshin vetëm banesa individuale me sipërfaqe ndërtimi deri në 250 m²) dhe në muajin shtator 2015 ku filluan të jepeshin leje ndërtimi sipas Planit të Përgjithshëm Vendor pasoi me një trend rritës të të ardhurave të arkëtuara nga kjo taksë për vitin 2016 krahasuar me vitet paraardhëse. Ky planifikim në këtë vlerë është bërë pasi pranë Bashkisë Korçë janë regjistruar elektronikisht një numër i madh kërkuësish për leje ndërtimi.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



TARIFË PËR SHËRBIM ME TAVOLINA JASHTË LOKALIT

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit	2,741,275	2,022,300	2,595,300	3,444,200	4,200,700	4,500,000

Tarifë për shërbim me tavolina jashtë lokalit për vitin 2017 është parashikuar 4,500,000 lekë, parashikim ky i cili bazohet në evidentimin e saktë nga ana e inspektorëve të numrit të tavolinave të biznesit të vogël dhe të madh që vendosin tavolina në hapësirë publike jashtë ambjenteve të lokaleve,



BASHKIA KORÇË

debitorët e krijuar deri në fund të vitit 2016 por dhe të viteve të mëparshme si dhe faktor kryesor për planifikimin në këtë masë është përdorimi dhe menaxhimi i hapësirës publike duke pasur në fokus kufizimin e lejeve për këtë lloj shërbimi, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi i cili përjashton lejimin e zënies së lulishteve me tavolina.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




TARIFA E PASTRIMIT

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifa e Pastrimit	49,719,607	58,843,384	62,825,304	73,698,794	107,577,847	117,000,000

Tarifa e pastrimit për vitin 2017 planifikohet të jetë në vlerën 117,000,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga subjektet e biznesit të vogël të Bashkisë Korçë në vlerën 21,705,050 lekë, nga subjektet e biznesit të madh të Bashkisë Korçë në vlerën 26,760,000 lekë, nga familjarët e njësisë administrative Korçë parashikohet në vlerën 42,000,000 lekë, nga familjarët e njësive administrative të Bashkisë Korçë parashikohet në vlerën 8,772,000 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve biznesit të Bashkisë Korçë parashikohet në vlerën 17,762,950 lekë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




TARIFË SHËRBIMI , VËRTETIME ,ÇERTIFIKATA

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë shërbimi, vërtetime, çertifikata	5,991,427	5,925,621	10,526,585	9,791,464	10,877,020	16,000,000

Të ardhura të tjera (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, etj) për vitin 2017 është planifikuar 16,000,000 lekë, parashikim ky i bazuar në realizimin e viteve të mëparshme por dhe në të dhënat e mara nga drejtoritë e ndryshme.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017






BASHKIA KORÇË

ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	0	0	0	0	58,800	50,000

Të ardhura nga çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2017 është planifikuar 50,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




MIRATIM PROJEKTI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Miratim projekti	0	0	0	0	305,500	500,000

Të ardhura nga miratim projekti për vitin 2017 është planifikuar 500,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017





BASHKIA KORÇË

SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruara	0	0	0	0	0	90,000

Të ardhura nga shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruara për vitin 2017 është planifikuar 90,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

SHËRBIME ZJARRFIKSE NË BASHKI FQINJE

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Shërbime zjarrfikëse në bashki fqinje	0	0	0	0	0	300,000


Të ardhura nga shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruara për vitin 2017 është planifikuar 300,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

MARRJE ME QIRA PYLLI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Marrje me qira pylli	0	0	0	0	86,850	4,800,000

Marje me qira pylli për vitin 2017 është planifikuar 4,800,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjorës pranë Bashkisë Korçë bazuar në kontratat ekzistuese, ato që priten të lidhen gjatë vitit 2017 por dhe në detyrimet e pa mbledhura gjatë vitit 2016.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017





BASHKIA KORÇË

TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT DHE HEQJA E MATERIALIT DRUSOR

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe heqja e materialit drusor	0	0	0	0	8,761,441	3,000,000

Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe heqja e materialit drusor për vitin 2017 është planifikuar 3,000,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



VËRTETIME TRANSPORTI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Vërtetime transporti	0	0	0	0	0	50,000

Të ardhura nga vërtetime transporti për vitin 2017 është planifikuar 50,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë.



BASHKIA KORÇË

TË ARDHURA NGA PRODHIMET E DYTA MEDICINALE

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhura nga prodhimet e dyta medicinale	0	0	0	0	0	100,000


Të ardhura nga prodhimet e dyta medicinale për vitin 2017 është planifikuar 100,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë.

TARIFË PARKIMI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë Parkimi	2,422,740	1,943,306	5,480,070	13,466,927	16,864,784	21,000,000

Tarifë parkimi për vitin 2017 është planifikuar 21,000,000 lekë, planifikim ky i kryer bazuar në vend parkimet e rezervuara, në të ardhurat që mbledh agjenti i parkimit privat, në numrin e mjeteve të transportit që do të marrin leje transporti qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, leje transport malli për llogari të vet, leje transport malli për të tretë, leje transporti për kamiona me peshë mbi 3,5 ton dhe licensat për mjetet taksi (1+4) dhe (1+8) që do të paguajnë këtë taksë gjatë vitit 2017 .

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017






BASHKIA KORÇË

GJOBA POLICIA BASHKIAKE

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjopa Policia Bashkiake	42,000	19,000	22,000	208,000	1,034,000	1,000,000

Gjopa Policia Bashkiake për vitin 2017 është planifikuar 1,000,000 lekë duke përfshirë dhe detyrimet e pa arkëtura nga vitit i mëparshëm.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



GJOBË PËR VONESË NË PAGESË

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjorbë për vonesë në pagesë	619,873	757,239	447,455	2,204,066	6,027,181	5,500,000

Gjorbë për vonesë në pagesë për vitin 2017 është planifikuar 5,500,000 lekë, parashikim ky i bazuar në detyrimet e papaguara të viteve të mëparshme (gjobat e biznesit të vogël), detyrimet e subjekteve të cilët nuk aritën që të kryenin pagesat brenda vitit 2016 për të cilat gjoba për vonesë në pagesë vazhdon të përllorarit.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



GJOBA TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	1,120,000	2,030,000	1,390,000	730,000	800,000	2,000,000

Gjopa të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2017 është planifikuar 2,000,000 lekë duke përfshirë këtu dhe gjopat e pa mbledhura nga vitet e mëparshme apo ato që janë në proces gjyqësor apo kanë kaluar në përmbarim për ekzekutim.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




**GJOBA TE DREJTORISE SE KONTROLLIT TE TERRITORIT**

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	125,000	55,000	33,000	149,000	581,100	1,000,000

Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2017 është planifikuar 1,000,000 lekë duke përfshirë këtu dhe gjopat e pa mbledhura nga vitet e mëparshëm.


Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017

**QERA OBJEKTI**

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Qira objekti, trualli, toke bujqësore e.t.j	1,550,338	819,935	1,305,032	2,198,063	4,233,856	14,620,471

Qira objekti, trualli, toke bujqësore e.t.j për vitin 2017 është planifikuar 14,620,471 lekë, bazuar në numrin dhe sipërfaqen e objekteve dhe pronave që Bashkia ka lëshuar me qira.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017


**TARIFE PËR DHËNIEN E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT**

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë për dhënie e treguesve të zhvillimit	0	0	192,000	90,000	277,000	700,000

Tarifë për dhënie e treguesve të zhvillimit për vitin 2017 është planifikuar 700,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Pavarësisht realizimit në nivele të ulta të kësaj takse për një periudhë 4 vjeçare pasi nuk ka patur miratime lejesh zhvillimore ndërtimi për arsye të pezullimit të tyre, fakti që dhënia e lejeve të ndërtimit filloi prej muajit mars të vitit 2015 me kufizime (lejoreshin të ndërtoreshin vetëm banesa individuale me sipërfaqe ndërtimi deri në 250 m²) dhe në muajin shtator 2015 ku filluan të jepeshin leje ndërtimi sipas Planit të Përgjithshëm Vendor pasoi me një trend rritës të të ardhurave të arkëtuara nga kjo taksë për vitin 2016 krahasuar me vitet paraardhëse. Ky planifikim në këtë vlerë është bërë pasi pranë Bashkisë Korçë janë regjistruar elektronikisht një numër i madh kërkesish për leje ndërtimi. Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



Tarifë për dhënien e treguesve të zhvillimit




TARIFE NDRIÇIMI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë Ndriçimi	15,424,960	17,774,749	23,704,862	27,549,002	35,778,744	39,955,000

Tarifë ndriçimi për vitin 2017 planifikohet të jetë në vlerën 39,955,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga subjektet e biznesit të vogël të Bashkisë Korçë në vlerën 10,960,000 lekë, nga subjektet e biznesit të madh të Bashkisë Korçë në vlerën 5,800,000 lekë, nga familjarët e njësisë administrative Korçë parashikohet në vlerën 14,000,000 lekë, nga familjarët e njësisë administrative të Bashkisë Korçë parashikohet në vlerën 4,386,000 lekë si dhe nga debitorët familjarë dhe debitorët e subjekteve biznesit të Bashkisë Korçë parashikohet në vlerën 4,809,000 lekë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017

Tarifë Ndriçimi





BASHKIA KORÇË

TARIFË GJELBËRIMI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë Gjëlberimi	10,545,989	12,084,452	15,503,114	17,224,889	21,992,600	26,000,000

Tarifa e gjëlberimit për vitin 2017 planifikohet të jetë në vlerën 26,000,000 lekë. Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga subjektet e biznesit të vogël të Bashkisë Korçë në vlerën 8,200,000 lekë, nga subjektet e biznesit të madh të Bashkisë Korçë në vlerën 3,500,000 lekë, nga familjarët e njësisë administrative Korçë parashikohet në vlerën 10,000,000 lekë, nga debitorët familjarë dhe ata të subjekteve biznesit të Bashkisë Korçë në vlerën 4,300,000 lekë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike	377,060	337,820	679,464	657,368	1,225,141	2,000,000

Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike për vitin 2017 është planifikuar 2,000,000 lekë duke u bazuar në të dhënat e marra nga inspektorët të cilët kanë inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet që kanë zënë prona publike, në realizimin e vitit 2016, subjektet apo pronarët që detyrohen ta paguajnë këtë tarifë dhe që nuk e kanë paguar brenda vitit 2016 apo dhe ata të viteve të mëparshme.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



TAKSË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksë për zënie e hapësirave publike	283,457	355,005	447,965	637,434	7,309,807	8,000,000

Taksë për zënie e hapësirave publike për vitin 2017 është planifikuar 8,000,000 lekë, bazuar në parashikimin e inspektorëve për sipërfaqet dhe zënie e hapësirës publike të cilat përdoren për qëllime të ndryshme siç janë zënie e hapësirave publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, etj, zënie e hapësirave publike për tregëtim në tregje publike të miratuara nga bashkia të artikujve ushqimorë, fruta – perime, vezë, mish, peshk, bulmet, e.t.j, zënie e hapësirave publike për tregëtim tek inkubatori i biznesit (ish UMB) të artikujve industrial, zënie e hapësirave publike për organizim evente të ndryshme, panairë, zënie e hapësirave publike për tregëtim të artikujve industriale të artikujve ushqimorë, fruta – perime, kantina, kënde lojrash etj.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksa mbi tokën bujqësore	3,760,957	439,137	949,248	10,076,503	21,724,693	36,500,000

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2017 është planifikuar 36,500,000 lekë bazuar në llogaritjen vjetore të vlerës të arkëtueshme referuar informacionit por dhe kategorisë të tokës bujqësore kjo nga të dhënat që ne dispononim në lidhje me sipërfaqet e tokës bujqësore të Njësisë Administrative Korçë, në të dhënat e marra nga Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë, duke përfshirë këtu dhe debitorët e krijuar të cilët nuk e kanë paguar këtë taksë gjatë vitit 2016 dhe në vitet e mëparshme.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




**TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)**

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhura nga qiratë (banesa sociale)	0	0	3,587,703	6,583,953	6,811,915	6,876,000

Të ardhura nga qiratë (banesa sociale) për vitin 2017 do të jenë 6,876,000 lekë. Parashikim ky i Njesisë së Menaxhimit të Banesave me qëllim social bazuar në numrin dhe sipërfaqet e apartamenteve që disponojnë.


Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017

**TAKSË E PËRKOZHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (TELEFONI, ENERGI, TV KABLLOR, INTERNET)**

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Taksë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore	0	0	0	0	1,884,000	3,200,000

Taksa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore për vitin 2017 është planifikuar **3,200,000** lekë parashikim ku i bazuar në të dhënat që ne disponojmë në lidhje me përlogaritjen e kësaj takse, përfshirë dhe detyrimet e prapambetura që subjektet i kanë Bashkisë Korçë.


Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017

**TË ARDHURA NGA QERATË (BANESA NË PRONËSI TË BASHKISË ENTI I BANESAVE)**

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Të ardhura nga qiratë (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave)	0	0	4,678,958	3,743,702	3,258,472	5,272,800

Të ardhura nga qiratë (banesave që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave) për vitin 2017 parashikohet në vlerën 5,272,800 lekë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017






BASHKIA KORÇË

TARIFË MIRËMBAJTJE VOREZA PUBLIKE

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë mirëmbajtje voreza publike	0	0	0	1,059,477	10,309,987	17,000,000

Tarifë mirëmbajtje voreza publike për vitin 2017 është planifikuar 17,000,000 lekë bazuar kjo në të dhënat që ne disponojmë në lidhje me familjet efektive në Bashkinë Korçë konkretisht nga familjarët e njësive administrative Korçë parashikohet në vlerën 10,000,000 lekë, nga familjarët e njësive administrative të Bashkisë Korçë parashikohet në vlerën 4,386,000 lekë si dhe nga debitorët familjarë parashikohet në vlerën 2,614,000 lekë.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017




TARIFË UJI

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM					PLANIFIKIM
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Tarifë uji	0	0	0	2,216,856	2,508,010	2,550,000

Tarifë uji për vitin 2017 është planifikuar 2,550,000 lekë bazuar kjo në detyrimet e prapambetura në njësive administrative mbasi prej muajit qershor bazuar ne legjislacionin ne fuqi të gjithë ujësjellësat i kanë kaluar në varesi UKKO për një menaxhimin më mirë dhe më efektiv në mbledhjen e detyrimeve.

Më poshtë po paraqesim grafikisht realizimin ndër vite dhe planifikimin 2017



Të ardhurat nga institucionet e vartësisë

Për vitin 2017 të ardhurat nga Institucionet e vartësisë janë planifikuar në vlerën 16,088 mijë lekë. Detajimi i tyre do të jepet në materialin sipas institucioneve.

Transferta e pakushtëzuar 2017

Transferrat e pakushtëzuara janë të ardhura pa kthim dhe mbarten në vitin pasardhës. Njësitë e Qeverisjes vendore kanë autoritetin për të ndarë të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2017 ka karakteristikat e mëposhtme:

- E thjeshtë për tu kuptuar dhe zbatuar
- E bazuar në kritere që garantojnë funksionimin normal të NJQV
- Garanton një sistem më të drejtë ekualizimi
- Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të Reformës administrative-territoriale.


Vlera e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2017 është 395,385 mijë lekë e krahasuar me vitin 2016 ka një rritje prej 21,7% ose 70,577 mijë lekë më tepër dhe krahasuar me vitin 2013 ka një rritje prej 223%. ose 218,220 mijë lekë më tepër. Transferta e pakushtëzuar jepet e detajuar në vite si më poshtë.

000/lekë

Emërtimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Transferta e pakushtëzuar (grandi)	171,127	167,287	171,421	177,165	230,960	287,925	324,808	395,385



BASHKIA KORÇË



Transferta specifike 2017

Në buxhetin e vitit 2017 do të vazhdojnë të financohen nëpërmjet transfertës specifike funksionet e reja të cilat iu transferuan bashkive në vitin buxhetor 2016, si:

- Personeli edukativ dhe mbështetës në arsimin parashkollor,
- Personeli mbështetës i arsimit parauniversitar,
- Rrugët rurale rajonale,
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri,
- Shërbimi pyjor,
- Ujitja dhe kullimi

Funksionet e transferuara, për vitet 2016-2017 dhe vitin 2018, do të financohen nëpërmjet transfertave specifike të përcaktuara individualisht për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, për çdo funksion

Sipas ligjit të buxhetit, transfertat specifike parashikohet për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara në NJQV, të cilat mund të shtojnë edhe fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar

Në tabelën e mëposhtme paraqitet dhe transfertat specifike e funksioneve të reja që kaluan në varësi të Bashkisë.

/lekë

Emërtimi	Pl 2016	Pl 2017	Dif Pl17-Pl16	% Pl17/Pl16
Arsimi parashkollor	163,270,000	153,421,000	(9,849,000)	94%
Konviktet e arsimit parauniversitar	21,078,000	21,500,000	422,000	102%
Arsimi parauniversitar	14,855,949	14,855,949	-	100%
